

Numri i lëndës: 2021:117045

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05492070

CP.nr.175/2021

Gjykata Themelore Gjilan dega e V., Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Alush Sinani, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditores S.L. nga V., të cilin e përfaqëson M.H.avokate në Viti, ndaj debitorit Komuna e V., Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike kompensimi i pagave jubilarë dhe shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit ditor, në shumë prej 1,538.90 euro, gjykata jashtë seancës gjyqësore më datë 22.03.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

I.Përfundohet, procedura përmbartimore e kreditores S.L.nga V., të cilin e përfaqëson M.H.avokate në Viti, ndaj debitorit Komuna e V., Drejtoria Komunale për Arsim.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore Gjilan dega e V., kishte lejuar propozimin me nr. CP.nr.175/2021, të datës 14.06.2021, ndaj kreditores S.L.nga V., të cilin e përfaqëson M.H.avokate në Viti, ndaj debitorit Komuna e V., Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike kompensimi i pagave jubilarë dhe shpenzimeve të ushqimit ditor, në shumë prej 1,538.90 euro sipas dokumentit përmbartues akgjykimi C.nr.320/20 të datës 06.04.2021.

Gjykata, ka pranuar parashtrësën nga ana e të autorizuarit të kreditores, nga e cila parashtrësë ishte konfirmuar se debitori e ka përmbushur detyrimin në tërësi.

Gjykata pas vlerësimit të parashtrësës konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, që të përfundohet procedura përmbartimore ndaj debitorit duke u bazuar në parashtrësën e paraqitur, pranë kësaj Gjykate.

Pasi që gjykata ka konstatuar se debitori e kishte përmbushur detyrimin ndaj kreditores, gjykata konform nenin 42 parag.2 dhe 66 parag. 4 të LPP-së, ka përfunduar procedurën duke vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi

Andaj, në bazë të dispozitave të nenit 66 par.4 të LPP-së, dhe duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2021:117045, 22.03.2024**

Gj y q t a r i

Alush Sinani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimet të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.